



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primi/eno/Prodato Received/Delivery	20 - 11	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity	
SKUPSHTK	7030	2023	1/6	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1324/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1324/2023 të datës 24.10.2023, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga "Sylejman Vokshi", O-3, Hyrja 1, Nr. 5, në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 05/2023 të datës 06.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1324/2023 e datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 05/2023 i datës 06.10.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër protokollit 2279/2017 të datës 25.05.2017 në pozitën "Zyrtar i Arkivit" në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 11.05.2023 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ai ankuesit M.L ka dërguar email tek Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.5, 3.6, 3.8 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë për arsyet si në vijim: 1. Mospërmbushje e detyrave të punës; 2. Braktisja e punës

pse mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3. Kryerja e përsëritur, brenda se jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tersi, dhe 4. Shkelje e detyrimeve të përcaktuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

Më datë 16.05.2023 rasti i ankuesit është përcjell tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 15.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.02/2023 me të cilin ka shtyrë afatin për përfundimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit deri më datë 30.06.2023, ndërsa më datë 29.06.2023 ka nxjerr Vendimin me Nr. 03/2023 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi i 40% në pagë për periudhën 6 muaj si dhe ndalimi i ngritjes në detyrë duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 vjeçare".

Ankuesi përmes postës më datë 11.07.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 12.07.2023 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.951/2023 me numër protokoli 5135/2023, kundër Vendimit me Nr. 03/2023 të datës 29.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale ngase nuk ka argumentuar me asnjë provë pretendimit e iniciuesit të kërkesës, po ashtu ky komisioni i ka shqiptuar dy masa disiplinore në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.08.2023 ka nxjerr Vendim A.nr.951/2023 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses duke anuluar Vendimin me Nr. 03/2023 të Komisionit Disiplinor dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 06.10.2023 përveç tjerash duke ju referuar edhe vendimit të këshillit A.nr.951/2023 të datës 23.08.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 05/2023 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *ndalim për 40% në pagë për periudhën 6 muaj.*

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.05/2023 të datës 06.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 24.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6669/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.10.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli më datë 02.11.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6669/2023 të datës 24.10.2023 e

parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 05/2023 të datës 06.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Autorizimin e datës 16.10.2023; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 25.05.2017; Vendimin A.nr.951/2023 i datës 23.08.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.11.2023; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 14.06.2023; Ftesë e takimit e datës 12.06.2023, 09.06.2023, 08.06.2023 për ankuesin nga Sh.I; Njoftimin e datës 09.06.20-23 nga Sh.I për ankuesin; Ftesë për takim e datës 12.06.2023, 09.06.2023 dhe 08.06.2023 nga Sh.I për M.L; Raportin periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve për periudhën 01.03.2023 deri 29.09.2023; Fletë lëshimi me Nr. 1608 i datës 01.03.2023; Raporti Mjekësor/Kardiologjik i datës 29.04.2023; Raporti për zgjatjen e paaftësisë së përkohshme i datës 31.07.2023; Raporti nga konsulta i datës 12.06.2023, 08.06.2023; Emailin e datës 08.06.2023, 30.05.2023 nga T.B për V.J; Emailin e datës 05.06.2023, 02.06.2023 nga V.J për T.B; Emailin e datës 23.05.2023 nga ankuesi për T.B; Emailin e datës 09.06.2023 nga T.B për V.J, Z.O, V.Sh; Emailin e datës 08.06.2023 nga ankuesi për T.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pa bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.05/2023 të datës 06.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pretendon se Komisioni Disiplinor nuk e ka ftuar në seancë duke mos i dhënë mundësin të deklarohet; Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike pasi që nuk kam bërë asnjë shkelje disiplinore dhe po ashtu nuk ka dëshmi se cilat detyra të punës nuk janë përmbushur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat materiale të lëndës, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit më datë 11.05.2023, ka theksuar se ankuesi ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.5, 3.6, 3.8 3.10 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë (tekstin në vijim ligji i aplikuar) Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë për arsytet si në vijim: *1. Mospërmbushje e detyrave të punës; 2. Braktisja e punës pse mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3. Kryerja e përsëritur, brenda se jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tersi, dhe 4. Shkelje e detyrimeve të përcaktuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.*

Në kuptim të besueshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit me rastin e vendimmarrjes i'u referuar dispozitave të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën disiplinore të nëpunësve civilë, përkatësisht nenit 45 i cili kishte përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit",* nenit 46 ku citohet se: *1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të*

masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta... ndërsa "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë", nenit 47 ku kishte përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", nenit 50, i cili nen kishte përcaktuar se: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore".

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni Disiplinor nuk e ka ftuar në seancë duke mos i dhënë mundësin të deklarohet, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se më datë 08.06.2023 ankuesi përmes emailit është njoftuar nga Sh.I, që të merr pjesë në takim të Komisionit Disiplinor më datë 09.06.2023 në orën 14:30, mirëpo që kjo seancë është shtyrë për një datë tjetër me ç'rast ankuesi është njoftuar më datë 09.06.2023 përmes emailit nga Sh.I, kurse më datë 12.06.2023 ankuesi është ftuar në seancë të Komisionit Disiplinor për datën 14.06.2023 në orën 14:30, mirëpo ankuesi më datë 08.06.2023 përmes emailit ka kërkuar nga T.B që për shkak të gjendjes shëndetësore të pezullohet procedura pasi e ka të pamundur pranin në seancë. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit rastin e ankuesit e ka pasur në rishqyrtim sipas Vendimin A.nr.951/2023 i datës 23.08.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë edhe afati për vendosje rezulton të jetë sipas obligimit të këtij vendimi, kështu që sipas provave të lëndës Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi është ftuar në seance të Komisionit Disiplinor mirëpo i njëjti edhe pas datës 12.06.2023 kur është ftuar për herë të fundit nuk ka pasur ndonjë përgjigje, mbi këtë bazë Komisioni Disiplinor i ka përbushur kushtet ligjore të parapara me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: "1. Komisioni disiplinor fillon menjëherë shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore" dhe nenin 94 dhe 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rezultat i kësaj pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike pasi që nuk kam bërë asnjë shkelje disiplinore dhe po ashtu nuk ka dëshmi se

cilat detyra të punës nuk janë përmbushur, Kolegji i Këshillit fillimisht lidhur me mos prezencën e ankuesit në vendin e punës, konstaton se nga provat e lëndës rrjedhë se ankuesi nga data 03.01.2023 deri më datë 29.06.2023 vetëm në disa raste është evidentuar në punë konkretisht më datë 07.03.2023 nuk është evidentuar në hyrje ndërsa në dalje është evidentuar në orën 12:15, më datë 16.03.2023 nuk është evidentuar në hyrje ndërsa në dalje është evidentuar në orën 17:12, më datë 17.03.2023 nuk është evidentuar në hyrje ndërsa është evidentuar në dalje në orën 15:34, më datë 24.03.2023 nuk është evidentuar në hyrje ndërsa në dalje është evidentuar në orën 17:06, më datë 18.05.2023 është evidentuar në hyrje në orën 08:47 ndërsa nuk është evidentuar në dalje, më datë 19.05.2023 nuk është evidentuar në hyrje ndërsa në dalje është evidentuar në orën 12:41, më datë 23.05.2023 nuk është evidentuar në hyrje ndërsa në dalje është evidentuar në orën 16:52. Lidhur me mos prezencën në punë mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit më datë 06.04.2023 ka paralajmëruar ankuesin se më datë 17.03.2023 jemi takuar dhe jemi dakorduar që të na njoftoni për paraqitjen e rregullt në punë sipas orarit 08-16 mirëpo edhe pas kësaj ju nuk paraqiteni në punë, duke e paralajmëruar se ky do të jetë paralajmërimi i fundit dhe nëse nuk fillon të paraqitet në punë nga data 30.03.2023 do të ndërmerren masa dhe lënda do të iniciohet në komision disiplinor.

Duke marr parasysh këtë paralajmërim por edhe duke shikuar provat e lëndës, Kolegji i Konstaton se përveç datave të cekura si ma lartë ankuesi nuk është evidentuar në punë për periudhën e lartcekur, si rrjedhojë ankuesi me asnjë provë nuk e ka arsyetuar mungesën në punë, respektivisht i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka qenë në pushim vjetor apo mjekësor, kështu që ankuesi me veprimin e tillë ka bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 dhe 3.6 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil"*, duke mos respektuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, respektivisht dispozitat e nenit 4,9 dhe 12 paragrafi 1,2 dhe 5 e kësaj rregullore. .

Ndërlidhur me konstatimin si më lartë, dhe meqenëse konstatohet se ankuesi nuk ka qenë prezentë në punë për kohën e lartcekur dhe poashtu nuk është arsyetuar mungesa me asnjë provë relevante, Kolegji i Këshillit, konstaton se i njëjti nuk ka përmbushur as detyrat e punës të përcaktuara sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe me aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se mos prezencën në punë e ankuesit ka shkaktuar pasoja tek zyrtarët e tjerë të Arkivës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shkak që zyrtarët e tjerë është dashur që të mbulojnë edhe detyrat e punës së ankuesit, mbi këtë bazë ankuesi ka bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale. 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi"*.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi me veprimet e tij ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 paragrafi 1, dhe nenin 28 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"26.1. Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit. 28. Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo*

veprim apo mosveprim të tij", kështu që bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 05/2023 i datës 06.10.2023, ka vepruar në pajtim me nenin 45, nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.5, 3.6, 3.8 dhe 3.10, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenin 48 paragrafi 3, 50 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat të nenit 11, 12, 13 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa arsyetimi i këtij vendimi është në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji i Këshillit, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1324/2023, datë 20/11/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;